

ROVENA MERA

VARIACIONE REALE NË /R/

Në këtë punim objekt studimi përbëjnë mënyrat e ndryshme të realizimit të dy fonemave dridhëse /r/ dhe /rr/ të gjuhës shqipe. Vlen të përmendet që këto fonema i kundërvihen njëra-tjetrës vetëm me një tipar: numri i dridhjeve; kështu alternimi i tyre është shumë i mundshëm në gjuhën e folur.

Është fjala për variante të realizimit të këtyre fonemave në nivele të ndryshme të ligjëritimit në shqip. Vendin kryesor ia kemi dhënë këtu ligjëritimit bisedor, kështu që studimi ka pasur si bazë për kërkime mënyrat e ndryshme të përdorimit të dridhësive në disa qytete të Jugut: Korçë, Berat, Vlorë dhe kryeqytet. Kërkimi në terren është orientuar nga parimet e punës që përdoren për studime të dialektologjisë urbane. Mbledhja e materialit faktik është bërë me anë të anketimit. Fletanketa përmban një pyetje të tërthortë që detyron të intervistuarin të japë një përgjigje të dëshiruar nga ne. Në përgjigje del detyrimisht një fjalë që përmban /rr/, në pozicion nistor ose ndërzanor. Të tilla zgjedhëm fjalët: birra, gorricë, arra, rrap, Durrës, racë. Anketuesi e drejton pyetjen me gojë dhe dëgjon me kujdes shqiptimin e fonemës dridhëse në fjalën e paramenduar. Në fletanketë shënohet /r/ose /rr/ në kolonën përkatëse (shih modelin të realizuar në fund të punimit). Kur ka qenë e mundur merren edhe të dhëna të tjera që shënohen në kolanat përkatëse të fletanketës. Kërkohet mosha, arsimi, profesioni, origjina dhe seksi.

Për të pasur të dhëna sa më pranë të vërtetës jemi përpjekur të bëjmë edhe një përzgjedhje të të intervistuarve me një shpërndarje të drejtë mes moshave dhe sekseve. Kemi operuar kështu me kampion (konceptin e kemi huazuar nga A. Varvaro)¹.

Të dhënat e grumbulluara nxjerrin në pah edhe probleme që janë drejtpërdrejt objekt studimi për Sociolinguistikën.

¹ W. Labov, *The stratification of English in New York City*, Washington, 1966, (sipas Varvaros, f. 82 dhe Berrutos: *Fondamenti di sociolinguistica*, Laterza, Bari, 1995, f. 160).

Fonemat /r/dhe /rr/ jo gjithmonë funksionojnë si dy fonema të ndryshme në shqip dhe alternimi i tyre (zakonisht rr>r) mund të përbëjë një tipar diferencues për folës a grupe folësish.

Shtysën për një punim të kësaj natyre e kemi marrë nga punime të autorëve të huaj. W. Labov ndër kërkimet e veta në New York pati edhe një kërkim të orientuar në diferencimet mes banorëve të qytetit në përdorimin e fonemës /r/. Nga ana tjetër, në Itali, Galli dhe Paratesi organizoi kërkime mbi shqiptimin e geminantes /rr/ në të rinjtë e Romës.²

Pra, si tipar diferencues në ligjërim, dridhëset janë parë edhe në gjuhë të tjera: diku përdorimi ose jo (alternimi r>0 në anglisht), diku humbja e kundërvënies (alternimi rr>r në italisht). Kërkimin e orientuar kemi synuar edhe në shembullin dhe metodat e Labovit.

Labov e realizon grumbullimin e materialit faktik përmes anketimit në vende publike. Për variacione në /r/ ai kërkon në një supermarket, ku mund të takojë njerëz të të gjitha kategorive. Duke u shtirur si i paorientuar pyet se ku ndodhet sektori i luleve. Në përgjigje i dalin detyrimisht fjalët “flower” (lule), “fourth” (i katërt) dhe “floor” (kat). Për përdorimin e dridhësive në gjuhën e librave (ku imponohet norma) problemet që do të diskutohen janë të një natyre krejt tjetër: na intereson këtu një diskutim për probleme të normës, si edhe vlerat stilistikore që mund të përftohen nga potenciali fonostilistik i dridhësive të shqipes.

Për drejtshkrimin e këtyre fonemave është hartuar një grup rregullash në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe*. Edhe aty problemi ekziston tek alternimi i tyre. Problem paraqesin sidomos fjalët me burim të huaj që kanë në gjuhën dhënëse një /rr/.

Jemi në terren të shqipes standarde dhe fonemat në objekt nuk përbëjnë më një variabël, por një çift në sistem.

Duke pasur parasysh që shqyrtojmë njëherë një tingull të shqipes së gjallë dhe një herë një të shqipes standard, variacionet që hasen do t'i ndajmë dhe do t'i emërtojmë konvencionalisht: variacione reale dhe variacione ideale.

Në gjuhësinë shqiptare punime të kësaj natyre nuk ka pasur. Nga kjo pikëpamje punimi ynë përbën të parin kontribut dhe është një sprovë në thelbin e vet. Për më tepër, variacionet në /r/ nuk kishte si të bëheshin objekt i ndonjë punimi të posaçëm. Megjithatë, gjuhëtarëve nuk u kanë

² G. De Paratesi, *Lingua toscana in bocca ambrosiana*. Tendenze verso l'italiano standard: un' inchiesta sociolinguistica, II Mulino, Bologna, 1984 (sipas Berrutos, f. 160).

shpëtuar fakte të rëndësishme ose që bien shpejt në sy. Gjatë hulumtimit në literaturën gjuhësore shqipe gjetëm pohime që përbëjnë kontribut jo të vogël. Vendin më të rëndësishëm e zënë këtu konkluzionet e dialektologëve.

Jorgji Gjinari në botimin “Dialektologjia shqiptare” shkruan se në të folmet e zonave të Korçës dhe të Beratit nuk haset fonema /rr/. Për këtë arsye këto të folme përbëjnë një areal dialektor më vete.³

Gjithashtu Jorgji Gjinari në “Dialektet e gjuhës shqipe” shprehet se fonema /rr/ është e panjohur edhe në të folmet e shumicës së banorëve me origjinë më të hershme qytetare të pothuaj gjithë qyteteve të Jugut.⁴

Ky pohim tregon qartë se jemi në një fazë të re të studimeve dialektore të shqipes. Nis të interesohet këtu Dialektologjia jonë edhe për popullsinë e qyteteve, që përjashtojë me parë si objekt i Dialektologjisë. Një interesim i tillë vonë ka nisur edhe në Europë (shih Varvaron)⁵.

Në botimin «Hyrje në gjuhësi» shkruhet: “Kështu prirja që vërehet në të folmet e qyteteve tona për zhdukjen e kundërvënies /r-rr/ nuk mund të shpjegohet sikur folësit më parë shpërnjohin këtë raport, pastaj kalojnë në rrafshin material”.⁶ Rrafshi material këtu do të thotë gjuhë e realizuar, variant i gjallë i shqipes (një interesim për gjuhën e folur).

Siç e kemi përmendur edhe më sipër vëzhgimin tonë e kemi përqendruar në disa qytete të Jugut. Atë ç’ka kemi vërejtur po e pasqyrojmë më poshtë.

Në qytetin e Korçës numri i të intervistuarve është 70. Theksojmë këtu se testimi është bërë në qytetarë krejt të rastësishëm. Jemi përqendruar në tregun e qytetit, për të vetmen arsye se aty kishim mundësi më të mëdha për të realizuar synimin tonë.

Pyetja e drejtuar ishte e tillë që kërkonte në përgjigje fjalën “birrë”. Këto persona, në numër total 70, janë ndarë:

45 persona përdorin fonemën /r/ dhe vetëm 25 persona përdorin fonemën /rr/, pra 64% e të intervistuarve përdorin /r/ dhe vetëm 36% përdorin /rr/.

Nga 29 femra të intervistuar, numri i atyre që përdorin /r/ është 19, ndërsa 10 të tjerat përdorin /rr/; 65 % e femrave përdorin /r/ dhe 35% / rr /.

³ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988

⁴ J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.

⁵ A. Varvaro, vep. e cit.

⁶ F. Agalliu, R. Memushaj, M. Reso, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 1989.

Te meshkujt 26 prej të intervistuarve përdorin fonemën /r/dhe 15 të tjerët përdorin fonemën /rr/; 63% përdorin /r/ dhe 37% përdorin /rr/. Për të dy grupet raporti është gati 2: 1 në favor të fonemës /r/.

Nuk vihen re, çuditërisht, luhatje në masën e përdorimit të /rr/ mes femrave dhe meshkujve. Kjo tregon, sipas mendimit tonë, që kemi të bëjmë me një tipar dialektor që mbartet nga pjesa dërrmuese e banorëve korçarë, pavarësisht nga seksi.

Është me interes të shohim këtu edhe diferencimet mes grupmoshave të ndryshme brenda të njëjtit seks.

Femrat nga mosha 15-25 vjeç ndahen në këtë raport: 80% përdorin fonemën /r/dhe vetëm 20% fonemën /rr/.

Femrat nga mosha 26-40 kanë një ndarje të barabartë përsa u përket masës së përdorimit të këtyre dy fonemave: 54 % me /r/ dhe 46 % me /rr/.

Edhe te femrat e moshës 41-60 vjeç nuk shihet ndonjë luhatje shumë e madhe në raport: 60% përdorin /r/ dhe 40% të tjerat /rr/.

Siç e shohim, femrat e qytetit të Korçës janë të prirura të përdorin më tepër fonemën dridhëse /r/. Në grupin e parë diferenca e madhe mund të përlligjet veç pasqyrimin të tipareve dialektore edhe nga një tendencë që vihet re lehtë të të rejtat për të shmangur geminanten /rr/. Problem ky që lidhet me etikën e ligjërit. Përdorin /r/ këtu edhe të rejtat e ardhura rishtas në Korçë, për të treguar përshtatshmëri ose për t'u identifikuar si banore të qytetit.

Në dy grupmoshat e tjera diferenca vjen e ulet. Ky fakt dëshmon një lloj shkujdesjeje për moshat e mëdha.

Gjithsej kemi intervistuar 41 meshkuj, nga të cilët, siç e thamë edhe me lart, 26 përdorin fonemën /r/ dhe 15 përdorin /rr/. Sipas grupmoshave kemi:

Meshkuj të moshës 15-25 vjeç

Te ky grup të rinjsh vërejmë se 75% e tyre përdorin fonemën /r/ dhe vetëm 25% fonemën /rr/. Pra, në një raport 1:3.

Te meshkujt e moshës 26-40 vjeç raporti i përdorimit të këtyre dy fonemave është 1 me 2, d.m.th. 66% e tyre përdorin fonemën /r/ dhe 34% fonemën /rr/.

Po të shohim grupin e tretë të të intervistuarve nga mosha 41-70 vjeç, vërejmë se raporti i përdorimit të dy fonemave ulet akoma më tepër, 55% persona përdorin /r/ dhe 45% përdorin fonemën /rr/.

Në bazë të të dhënave shohim se edhe te të rinjtë raporti i përdorimit të /r/ dhe /rr/ vjen duke ulur. Pra, përputhet kjo e dhënë me atë të femrave dhe

dëshmon edhe një herë që nuk kemi dallime mes sekseve, por vetëm në moshë.

Me rritjen e moshës ky raport vjen duke u ulur gjithnjë e më tepër si për femra, edhe për meshkuj.

Në qytetin e Beratit vëzhgimet i kemi kryer tek «Ura e Gorricës». Pyetja e drejtuar ishte «Si quhet ky vend?»

Pozicioni i kësaj ure të jepte mundësinë që të bisedojë edhe me persona me origjinë beratase të cilët i përkisnin lagjes «Gorricë», por edhe banorë të lagjes në të hyrë të Beratit me popullsi heterogjene.

Të dhënat në këtë qytet na japin këtë gjendje:

Nga 62 të intervistuar 40 ishin vendas (që përdornin të gjithë fonemën /r/) dhe 22 persona të ardhur.

Nga numri total i femrave, 28 prej tyre përdorin fonemën /r/ dhe vetëm 5 fonemën /rr/ (është e lehtë të identifikosh të ardhurat).

Sipas grupmoshave, ndarjet në përdorues të fonemës /r/ dhe përdorues të fonemës /rr/ nuk na japin asgjë. Diferencat tregojnë thjesht origjinën.

Ja gjendja.

Femrat e moshës 15-25 vjeç;

72 % e femrave të kësaj moshe përdorin fonemën /r/ dhe 28% fonemën /rr/. Pra, raporti 2,5 me 1.

Te femrat e moshës 26-40 vjeç asnjëra nuk përdor fonemën /rr/.

Të të intervistuarat e moshës 41-65 vjeç raporti është 1 me 5, sepse 83 % përdorin fonemën /r/ dhe vetëm 17 % fonemën /rr/.

Nga 29 meshkuj të intervistuar, 54% përdorin fonemën /r/ dhe 46% fonemën /rr/. Siç shihet diferenca është shumë më e vogël se te femrat, kuptohet, meshkujt lëvizin më shumë.

Ajo çka nxjerrim si përfundim në fund të vëzhgimeve është se në qytetin e Beratit fonema /rr/ është shumë më e rrallë se në qytetin e Korçës dhe se në Berat nuk ka kuptim të kërkosh diferencime as mes sekseve, as mes grupmoshave. Dallimet varen nga fakti se ç'origjinë ka folësi. Të gjithë personat të cilët përdorin fonemën /r/ janë beratase dhe të gjithë ata që përdorin /rr/ janë të ardhur. Kjo provon mendimin e J. Gjinarit që cituam në shënimin nr. 4.

Nga 22 personat e ardhur në këtë qytet, të cilët ne arritëm t'i intervistojmë, vetëm 4 përdorin fonemën /r/ (edhe këtu një lloj përshtatjeje), të tjerët përdornin fonemën /rr/.

Gjendja në qytetin e Vlorës paraqitet e tillë:

Nga 54 të intervistuar 44 janë vendas që i përdorin të dy fonemat me këtë raport: 16% përdorin fonemën /r/ dhe 84 % të tjerë përdorin fonemën /rr/.

Duke i grupuar sipas moshës kemi:

Te femrat e moshës 15-25 vjeç; 37% përdorin fonemën /r/ dhe 63% fonemën /rr/.

Te femrat e moshës 26-40 vjeç, raporti i përdorimit të këtyre dy fonemave është 1 me 2, sepse 33% përdorin fonemën /r/ dhe 67% fonemën /rr/.

Në grupmoshën nga 41-60 vjeç; ky raport është 1 me 1, pra nga 8 të intervistuar 4 përdorin fonemën /r/ dhe 4 të tjerat fonemën /rr/.

Po të shohim meshkujt e moshës 15-25 vjeç, raporti i përdorimit të këtyre dy fonemave është shumë i thellë, sepse 15 % e të intervistuarve përdorin /r/ përkundrajt 85% që përdorin fonemën /rr/.

Te meshkujt e moshës 26-40 vjeç, ky raport është 1 me 2,5.

Edhe te meshkujt e moshës 41-70 vjeç, raporti është shumë i thellë; 1 me 8; vetëm 2 përdorin /r/ dhe 16 të tjerë /rr/.

Nga statistikat shohim që edhe meshkujt edhe femrat përdorin /rr/ më tepër sesa /r/, por te meshkujt raporti i përdorimit të këtyre dy fonemave është shumë më i thellë se te femrat.

Në qytetin e Vlorës kemi një gjendje krejt të kundërt me atë të qyteteve që bashkohen në arealin nr. 2.⁷

Në Vlorë nuk vihet re as tendenca për shmangien e /rr/ në brezin e ri gjë që spikaste, thamë, në Korçë e Berat. Nuk mund të thuhet se ky rezultat dëshmon respektimin e normës drejtshqiptimore (hasen plot luhatje), por në Vlorë vihet re një tendencë në kah të kundërt; fonema /rr/ del edhe kur takohet me një bashkëtingëllore: motrre, zemrre (natyrisht numri dridhjeve nuk është 4 si në /rr/ e shqipes standard, por dy deri në tre, diçka mes /r/ dhe /rr/).

Tirana ka një popullsi shumë heterogjene, gjë që e dëshmojnë edhe të dhënat e testimit. Nga 78 të intervistuarit 38 janë vendas dhe 40 janë të ardhur. Nga totali, 15 persona përdorin /r/ dhe 63 përdorin /rr/.

Nga 32 femrat e intervistuar, 14 përdorin fonemën /r/ dhe 18 fonemën /rr/.

Nga statistikat mund të vërejmë që femrat e moshës 15-25 vjeç janë të prirura të përdorin më tepër fonemën /r/, pra 8 prej tyre përdorin fonemën /r/ dhe 3 fonemën /rr/. Ndërsa femrat e dy grupmoshave të tjera, pra, nga

⁷ Shih: J. Gjinari, vep. e cit, f. 56.

26-40 dhe nga 41-65 vjeç janë të prirura të përdorin fonemën /rr/. Ndihet tendenca për eliminimin e /rr/ në pozicion nistor ose në pozicion ndërzanor, gjithnjë për etikë apo delikatesë ligjërimore.

Nga 46 meshkujt e intervistuar vetëm 6 përdorin fonemën /r/ dhe 40 të tjerët përdorin fonemën /rr/. Nga statistikën shohim se për të tre grupmoshat raporti i përdorimit të këtyre dy fonemave është shumë i thellë: 1 me 11 në favor të /rr/ për meshkujt e moshës nga 15-25 vjeç; 1 me 6 në favor të /rr/ për meshkujt e moshës nga 26-40 vjeç; dhe 1 me 8 përsëri në favor të /rr/ për meshkujt e moshës nga 41-70 vjeç.

Nuk përfshihen meshkujt e Tiranës në tendencën për eliminimin e /rr/, sipas të dhënave që kemi në dorë.

PËRFUNDIME

Natyra fonetike e fonemave dridhëse të shqipes dhe natyra e kundërvënies që ato realizojnë me njëra-tjetrën dhe me fonemat e tjera të shqipes japin mundësi të mëdha për t'i konsideruar /r/ dhe /rr/ variable në studime mbi natyrën variative të gjuhës dhe mbi variacione reale në gjuhën e gjallë.

Diferencimet gjuhësore që mund të realizohen nga këto variable janë të natyrës dialektore dhe sociale.

Në planin dialektor dallohen të folmet e zonave të Beratit dhe të Korçës në përdorimin rregullisht të fonemës /r/, nga ana tjetër, dallohet zona e Vlorës me përdorimin rregullisht të fonemës /rr/.

Në këndvështrim social diferencimet mund të hasen mes grupeve me seks të ndryshme dhe grupeve me moshë të ndryshme.

Kështu, në folësit e moshave 15-25 vjeç të zonës së Korçës, pa dallim seksi, vihet re prirja për shmangien e fonemës /rr/.

Kjo prirje vihet re edhe në Tiranë, por vetëm te femrat e kësaj moshe. Krijohet ideja e ndjekjes së një lloji mode nga të rinjtë, pasi, me rritjen e moshës raporti /r/: /rr/ ndryshon në favor të /rr/.

Në zonën e Beratit diferencimet nuk prekin moshat dhe seksin, por vetëm origjinën. Në Berat, banorët me origjinë vendase në ligjërimin e shkujdesur pothuaj nuk përdorin fare /rr/. Folësit që realizonin /rr/ na rezultuan të gjithë të ardhur.

Në Tiranë janë të prirur të përdorin /r/ folësit me qëndrim të gjatë në qytet dhe prirjen të respektojnë normën të ardhurit vitet e fundit.

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, F., Memushaj, R., Reso, M., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 1989.
Berruto, G., *Fondamenti di sociolinguistica*, Laterza, Bari, 1995.
Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973.
Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, 1, Tiranë, 1985.
Gjinari, J., *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
Varvaro, A., *La lingua e la società*, Guida editori, Napoli, 1978.